



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-19208 dt. 19/04/2024

PROCESVERBALI

I mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: **29.03.2024** e cila filloi në orën 10:00.

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Komunal-Milaim Hajdari

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 31 anëtarë: Labinot Halilaj (PDK), Bekim Lestrani (PDK), Arigon Sinani (PDK), Zeqir Hasi (PDK), Laurita Muhadri Bujupi (PDK), Hamit Kastrati (PDK), Blerina Gashi (PDK), Gani Krasniqi (PDK), Fatmir Baliu (PDK), Qendrim Mulaj (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Blerina Gashi (PDK), Valentina Leku (PDK), Manushaqe Mulaku (PDK), Mirlinda Dvorani (PDK) Sali Dvorani (DD), Mergim Pirraku (DD), Mehedin Salihu (DD), Hamit Haxhiu (DD), Jahir Hajdari (DD), Azemine Bujupi-Gjoka (DD), Marigona Bazaj (DD), Florentina Elezi-Veliu (VV), Filloreta Bujupi (VV), Drin Halilaj (VV), Egzona Terrdevci (VV), Muhamet Kurtaj (VV), Arbër Halilaj (GREEN), Beqir Kiqina (AAK), Egzon Qorri (LDK). Sali Dvorani (DD).

Të pranishëm ishin edhe Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, Nënkyetari Arben Shala, Drejtor të Drejtorive komunale, përfaqësues të KFOR-it, përfaqësues të OSBE-s zyra e informimit, sekretari organizativ i Qendrës të LVV Nëntor Zeka.

Mbledhja filloi punimet me këtë rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal i mbajtur më dt. 29.02.2024.
2. Propozim vendim për plotësim ndryshimin e Statutit të Komunës së Drenasit lidhur me emërtimin kompetencat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
3. Propozim vendim për plotësim ndryshim të vendimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
4. Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 25 vite të pronës komunale të Komunës së Drenasit Ministrisë së Punëve të Brendshme – Policisë së Kosovës, për ndërtimin e nënstacionit Policor në zonën kadastrale Komoran të Komunës së Drenasit.
5. Propozim vendim për vazhdimin e afatit të zbatimit të Planit për vlerësimin e Rrezikut për territorin e Komunës së Drenasit, 2021-2023, deri në hartimin e Planit të Ri të vlerësimit të Rrezikshmërisë.
6. Raporti përfundimtar për implementimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2022.
7. Raport i Planit të Biznesit 2024 të NPL "Stacioni i Autobusëve" SHA-Drenas.
8. Të ndryshme.

Mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Drenasit u mbajt me dt. 29.03.2024, ku për diskutim ishin 8 pika për rend dite. Mbledhja është kryesuar nga kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari.

Kryesuesi hapi punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal ku njoftoi me rendin e ditës e lartcekur. Diskutime për rendin e ditës.

Egzona Tërdevci: Në emër të grupit të LVV propozoj që të shtyhet pika e katërt e rendit të ditës, pra propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 25 vite të pronës komunale të Komunës së Drenasit Ministrisë së Punëve të Brendshme – Policisë së Kosovës, për ndërtimin e nënstacionit Policor në zonën kadastrale Komoran të Komunës së Drenasit, arsyeja se pse propozoj që kjo pikë të shtyhet për një seancë tjetër është se ne kemi marrë informacione që kjo pronë është në kontest gjyqësor pra iu është dhënë një vendim agjencisë kadastrale të Kosovës që të mos iniciohet asnjë procedurë lidhur me këtë pronë, për mua si asamblesite është e çuditshme që drejtori i Policisë të kërkojë ekskluzivisht një pronë të caktuar, duke u bazuar që një pronë në kontest gjyqësor nuk mund t'i jepet dikujt tjetër propozoj që kjo pikë të shtyhet për një seancë tjetër.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: prona të cilën e ka kërkuar Drejtori i Policisë së Kosovës si nënstacion i stacionit të Drenasit më qellim të sigurisë të gjithë banoreve të asaj pjese të banoreve jo vetëm të komunës tonë sepse autostrada "Ibrahim Rugova" kalon buzë objektit të komunës, pronë e komunës, ne emër të komunës, kushdo që ka thënë që ka kontest gjyqësor ju mashtron juve dhe provon me e mashtruar edhe opinionin, asnjë kontest jo për atë pronë por për asnjë pronë nuk i sjelli vendimet ku janë në kontest sepse unë shkoj në përgjegjësi nuk shkon tjetër kush, kështu që unë kërkoj për hir të sigurisë të gjithë qytetareve të komunës tonë, për hir të shtimit të numrit të policeve në stacionin e komunës, për hir të shërbimeve edhe hapjes së institucioneve bankare ta votoni kërkesën e drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës, çdo vlerësim dhe çdo matje u bë dhe është vendi më adekuat në Kosovë që me qenë edhe pjesa e Policisë së Kosovës të komunikacionit sepse për 30 min gjithë kufijtë e Kosovës prej aty janë në dispozicion të sigurisë së qytetareve, ju ftoj me votu, prona është e Komunës së Drenasit.

Egzona Tërdevci: ne nuk jemi kundër Policisë së Kosovës e as kundër kërkesës së tyre thjesht ne konsiderojmë që ai lokacion nuk është i përshtatshëm, kërkoj ta shtyjmë për seancën tjetër këtë pikë, sjellna dokumentet që nuk është kontest gjyqësor dhe ne do ta votojmë, dhe nuk mund të marrim vendim kur ka amulli të informacioneve sepse konsideroj që kjo e dëmton edhe Policinë e Kosovës direkt, prandaj le ta shtyjnë për një seancë tjetër ku i kemi informacionet e detajuara dhe e votojmë pse jo.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: Policia e Kosovës i ka dërguar gjitha komisionet e veta për ta verifikuar dhe për ta vlerësuar vendin dhe pronën, ekspertet e policisë e kanë inspektu, e kanë vlerësua e kanë studiuar dhe e kanë bërë kërkesën dhe kjo është vetëm në dorën tuaj.

Marigona Bazaj, edhe ne si DD jemi për me e shty këtë pikë të rendit të ditës pasi që ekziston një aktvendim nga agjencia kadastrale e Kosovës për pezullim të çdo aktiviteti për parcelën në fjalë derisa ta jep verdiktin përfundimtar gjykata pasi që pala që e ka pas në shfrytëzim ka bërë padi për njohjen në pronësi të kësaj parcele sipas ligjeve në fuqi, prandaj për këtë pikë kërkojmë të shtyhet dhe të propozohet edhe parcelat tjera dhe të shikojmë se cili

është vendi më i përshtatshëm për stacionin policor pasi që në parim jemi që në Komoran të këtë stacion policor por në një hapësirë më të përshtatshme.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: nëse ju keni vendim të agjencionit a mundeni me e shpërmda që ne ta përdorim që ju e keni sjellë një vendim të agjencionit kadastral të Kosovës. Ne mund ta shikojmë tek agjencioni kadastral të Kosovës ku e vërteton që prona është e komunës në emër të komunës dhe që policia e Kosovës e ka bërë vlerësimin e gjithë dokumenteve dhe ka bërë vlerësimin e objektit dhe e ka bërë kërkesën, nuk e kemi bërë ne kërkesën e ka bërë Policia kërkesën, kështu që ju lutem nëse keni dokument na prezantoni ta shohim edhe ne.

Labinot Halilaj: kërkoj që ta respektojmë propozimin e koleges, a ta vendosim ne rend dite apo jo pikën e katërt, mandej ta votojmë rendin e ditës.

Arbër Halilaj: të gjithë jemi për plotësimin e kërkesave dhe nevojave të Policisë të Kosovës, kërkoj që të na prezantohet kërkesa e Policisë së Kosovës dhe ashtu siç ju ka kërkuar prona e caktuar të ju kërkohet t'i bashkëngjisin edhe dy prona tjera alternative, kështu që ta kemi opsionin me tri prona dhe ne si pozitë dhe si kuvend në përgjithësi e kemi më të lehtë ta votojmë, dhe me vet faktin që ngiten këso paqartësi nuk është kërkesë e pa arsyeshme shtyrja e kësaj pike për seancën e radhës, kërkoj që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës për muajt e ardhshëm.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: kopjen e kërkesës së Policisë së Kosovës e ki në materialin e bashkangjitur, ju ftoj ta votoni ju vendosni.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari, hodhi në votim kërkesën e grupit të LVV që propozoj që të shtyhet pika e katërt e rendit të ditës, pra propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 25 vite të pronës komunale të Komunës së Drenasit Ministrisë së Punëve të Brendshme – Policisë së Kosovës, për ndërtimin e nënstacionit Policor në zonën kadastrale Komoran të Komunës së Drenasit “Për” votuan 15 anëtar, Kundër 15, abstenim 1, nuk u votua që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hodhi në votim rendin e ditës të lartcekur, prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, “Për” votuan 25 anëtar, 4 kundër, abstenim nuk pati u miratua rendi i ditës pa ndryshime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: 1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 29.02.2024.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar, “Për” votuan 30 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: 2. Propozim vendim për plotësim ndryshimin e Statutit të Komunës së Drenasit lidhur me emërtimin kompetencat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

Egzona Tërdevci: kërkoj sqarim rreth kësaj pike të rendit të ditës, e kam shikuar dokumentacionin e kësaj pike dhe momerandunimin mirëpo në bazë të momerandumit dhe arsyetimit thotë se do të formohet një komision, kur do të formohet ky komision dhe çfarë përbërje ka me e pas që ka me i përcaktu kompetencat e reja të drejtorisë.

Anita Avdullahu, drejtoreshë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural : Me datë 27.12.2023 Komuna e Drenasit ka lidhur Memorandum të bashkëpunimit me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural si dhe Ministrinë e Administrimit të Pushtetit lokal për transferimin nga Komuna e Drenasit në Agjencinë Pyjore të Kosovës të stafit të Pylltarisë, rojeve të pyllit, teknikeve të pylltarisë, përgjegjësive të njësisë komunale etj bashkë me mjetet buxhetore përkatëse, automjetet dhe pajisjet e tjera si dhe mjetet tjera përkatëse funksionale që lidhen me përgjegjesitë dhe detyrat e ndryshme pyjore. Andaj duke marrë parasysh Memorandumin e lartëcekur dhe faktin se stafi i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural tashmë ka kaluar në Agjencinë Pyjore të Kosovës përmes këtij dokumenti propozohet që në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe brenda kometencave të veta Kuvendi i Komunës të aprovoj Propozimin Vendimin Për plotësim ndryshimin e Statutit të Komunës së Drenasit duke e riformuluar emërtimin e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural si dhe si dhe të formohet Komisioni i cili do të ketë për detyrë modifikojë kompetencat dhe përgjegjesitë e kësaj Drejtorie. Komisioni formohet pasi të kaloj kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, “Për” votuan 29 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: 3. Propozim vendim për plotësim ndryshim të vendimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 28 anëtar, “Për” votuan 28 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kuvendi mori pauzë 15 minuta.

Pas pauze kuvendi vazhdoi punimet tek pika e 4 e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e katër të rendit të ditës: 4. Propozim vendim për dhënie në shfrytëzim afatgjatë për 25 vite të pronës komunale të Komunës së Drenasit Ministrisë së Punëve të Brendshme – Policisë së Kosovës, për ndërtimin e nënstacionit Policor në zonën kadastrale Komoran të Komunës së Drenasit.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: për hir të interesit të përgjithshëm dhe sigurisë të qytetareve tanë dhe me kërkesë të grupit parlamentar të asamblesë të LVV unë kërkoj mirëkuptimin e juaj ta tërheq piken e katër nga rendi i ditës për mbledhjen e ardhshme por njëkohësisht po kërkoj që të gjithë ata që flasin kërkoj që t'i sjellim dokumentet e agjencionit kadastral.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim që pika e katërt e rendit të ditës të tërhiqet nga rendi i ditës me kërkesën e Kryetarit dhe grupit të LVV: prezent gjatë votimit ishin 31 anëtar, “Për” votuan 29 anëtar, kundër 2, abstenim nuk pati, pika e 4 e rendit u tërhoq nga rendi i ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5. Propozim vendim për vazhdimin e afatit të zbatimit të Planit për vlerësimin e Rrezikut për territorin e Komunës së Drenasit, 2021-2023, deri në hartimin e Planit të Ri të vlerësimit të Rrezikshmërisë.**

Nexhmedin Gruda- Drejtor i Shërbimeve Publike dhe emergjente: Plani i ri për vlerësimin e rrezikut për territorin e Komunës së Drenasit të hartohet në përputhje me rregulloren nr 25/2020 RREGULLORE (ORK) Nr. 25/2020 PËR METODOLOGJINË E HARTIMIT TË VLERËSIMIT TË RREZIKSHMËRISË, andaj ne kërkojmë që afati i planit të ri të zgjatet marrë parasysh edhe nevojën e këtij plani për performancën komunale. Pas hartimit të Planit Zhvillimor Komunal, Planeve Rregulluese Urbane dhe Hartës Zonale për Komunën e Drenasit, është shtruar nevoja edhe për shqyrtimin e Planit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë për territorin e Komunës së Drenasit, që të dhënat në këtë plan të jenë të njëjta si në planet e lartshënuara, sepse, ka pasur ndryshime në ndërtime, infrastrukturë përcjellëse (rrugë, trotuare, ujësjellës, kanalizim, ndriçim) e të tjera. Një dokument i tillë u drejtohet me propozimin për miratimin e tij duke marrë parasysh faktin se sipas legjislacionit në fuqi, Kryetari i Komunës obligohet që së bashku me mendimin e tij të njëjtin ta dorëzojë në Kuvendin e Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 27 anëtar, “Për” votuan 27 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: **6. Raporti përfundimtar për implementimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2022.**

Egzona Tërdevci: pyeti: gjetja e parë është për kontratat kolektive pagat jubilarë etj por është edhe një gjetje për keqklasifikim të shpenzimeve në vlerë prej 145 mijë euro a janë marrë masat e duhura që kjo gjetje mos të përseritet prape për vitin 2023. Dhe është rekomandimi i pestë që ju është dhënë komunës për angazhimet përmes prokurimit të stafit, e keni cek që në vitin 2023 e keni pas të detyrueshëm ta angazhoni një konsulent nëse mundemi me e ditë për qka është angazhuar ai konsulent.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: e keni planin e zbatimit të rekomandimeve të gjetjeve të auditorit ne i kemi marrë masat ne jemi të obliguar me i marrë masat, sa i përket kontratave janë 3 kontrata të vazhduara që ka pas të bëj me punëtorët të cilët i kemi

angazhuar në institucionet sportive siç është stadioni, salla e sporteve edhe për atë janë thirr zyraret tonë në përgjegjësi.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës: **7. Raport i Planit të Biznesit 2024 të NPL “Stacioni i Autobusëve” SHA-Drenas.**

Aurora Berisha: krye shefe e ndërmarrjes të NPL “Stacioni i Autobusëve” SHA-Drenas, viti 2024 do të jetë një vit sfidues për ndërmarrjen duke qenë se është viti i parë që ndërmarrja operon si e plot me bord, menaxhimet staf bazik. Gjendja faktike e ndërmarrjes ndonëse me sfida të mëdha të cilat rendojnë gjendjen financiare të ndërmarrjes siç janë të hyrat e ulta në ndërmarrje si pasojë e kushteve jo të përshtatshme operuese të stacionit, procesi i licensiit të stacionit, mungesa e hapësirave të përshtatshme të punës, mungesa e teknologjisë adekuate për operim më efikas të ndërmarrjes si dhe shpenzimet shumë të larta të trashëguara nga viti paraprak që kanë të bëjnë me mënyrën e gjenerimit të ardhurave nga aktiviteti primar dhe sekondar i ndërmarrjes.

Egzona Tërdevci: kërkoj sqarim për ndaljen e detyrueshme të operatoreve transportues që operojnë për rrugën Prishtinës-Skenderaj që e kanë transit Drenasit a ka ndërmarrje ndonjë mekanizëm i tillë që mundet me i detyrua me u ndal në stacion të autobusëve, dhe tjetra tek planifikimi i shpenzimeve për paga e përmendet që e keni vështirësi operative meqë keni pak punëtor por planifikimi për paga është kogja i lartë cilat janë përditshmëritë apo cili është plani i juaj sa ka me qenë numri i punëtorëve për atë planifikim të pagave. Edhe një pyetje për komunën a ka ndonjë planifikim për financim se në plan të biznesit të ndërmarrjes janë të planifikuara 60 mijë euro donacion nga komuna e në buxhet nuk ne kemi diskutuar një gjë të tillë.

Aurora Berisha: këto linja marrin rendin e udhëtimit nga ministria megjithatë rendi i udhëtimit duhet të respektohet në stacionet përkatëse ndonëse stacioni në Drenas është për lindjen Prishtinë Drenas dhe Skenderaj kjo është një procedurë e cila duhet të respektohet nga operatorët transportues. Ne për momentin i kemi vetëm 4 punëtor me të cilët nuk është i mjaftueshëm operimi në stacionin e autobusëve, ne synojmë që pagat të sistematizohen me ligjin për shërbyes publik dhe me rregulloret e brendshme prandaj planifikimi është në përputhje me ligjin e pagave.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: ky është një raport të cilën e ka përpiluar kompania të cilën e kemi formu ne, subvencionim për paga nuk kam të drejtë të bëj nëse na lejon ligji e bëjmë atë gjë, sa i përket investimeve ne i kemi marr përsipër me i bë investimet krejt ato çka mundemi t'i bëjmë jemi në proces.

Hamit Haxhiu: me ligj stacioni a duhet të ketë kontrata me kompanitë e autobusëve dhe ju a keni kontrata dhe pagesat e autobusëve që i kryeni në perona a është me kupton fiskal apo me paragona?

Aurora Berisha: është ligji për transportin publik, linjat e udhëtimit ndahen nga Drejtoria e shërbimeve publike dhe nga ministria, këto linja ne i marrim nga Drejtoria e Shërbimeve publike të cilat i kanë ndarë për tri vite në bazë të rregulloreve të cilët janë të hartuara po në këtë kuvend. Ndërsa sa i përket të hyrave të inkasimit ne kemi pas vështirësi të inkasojmë të hyra duke qenë se me herët janë inkasuar në formë të paragonave, për shkak se ndërmarrja nuk ka qenë e regjistruar ndërsa si e tillë nuk ka mundur të operoj edhe shoqëri tregtare

ndërsa tani me procedurat e regjistrimit dhe finalizimit të tyre ne jemi pajisur me arke fiskale ku te gjithë transportuesit pranojnë kuptonin fiskal për shërbimit e ofruar.


Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës: 8. Të ndryshme.

Nuk pati diskutime.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur seancën, seanca përfundoj rreth orës 11:50 min.


Me gjerësisht, mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Drenasit të datës 29.03.2024 mund të ndiqni në ueb faqen zyrtare të komunës, rrjetin social të Fecebook-ut dhe në kanalin YouTube.

Procesmbajtëse:


Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Milaim Hajdari